



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 11 Mars 2021

Nr: 07

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR.04,
DATË 09.03.2021 TË ZNJ. LEONORA HYSO NDAJ VENDIMIT TË
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE NR.30, DATË 15.12.2020

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.03.2021, me pjesëmarrjen e:

Illirjan RUSMALI - Kryesues
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

Ankues: Znj. Leonora Kiço Hyso, kandidate e Partisë Demokratia Sociale për këshillin bashkiak Vlorë në zgjedhjet për organet qeverisjes vendore të vitit 2019;

OBJEKTI: Shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.4 të znj. Leonora Hyso me objekt “Anullimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.30, datë 15.12.2020 “Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit z. Rudi Viron Pashaj nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 21, pika 1, shkronja "b" dhe neni 124/1, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 136, pika 2, e ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", nenet 18 dhe 30, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 "Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve",

Rrethanat e çështjes:

1. Në datën 14.08.2020 është krijuar një vakancë në këshillin e Bashkisë Vlorë për shkak të dorëheqjes së anëtarit të këshillit bashkiak z. Shkëlqim Leskaj. Në vijim të njoftimit me shkresën nr. 8072 prot., datë 22.09.2020 të këshillit të Bashkisë Vlorë, Komisioneri ka nisur dhe administruar procedurat ligjore të plotësimit të vakancës, të cilat e ngarkojnë me verifikimin e figurës së kandidatit vijues në listë për subjektin përkatës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Në kuadër të këtyre procedurave janë njoftuar nga ana e KQZ-së për të depozituar formularin e vetëdeklarimit dy kandidatë njeri pas tjetrit, zoti Rudi Pashaj, kandidat i Partisë Socialiste të Shqipërisë, pjesë e koalicionit zgjedhor "Aleanca për Shqipërinë Evropiane", më datë 14.10.2020 dhe zonja Leonora Hyso, kandidate e Partisë Demokratia Sociale, pjesë e koalicionit zgjedhor "Aleanca për Shqipërinë Evropiane", më datë 06.11.2020. Njoftimi i znj. Hyso është bërë për shkak se z. Pashaj nuk ka depozituar formularin brenda afatit 10 ditor që përcakton pika 3 e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
2. Kandidati i njoftuar fillimisht, z. Rudi Pashaj ka depozituar ankesë dhe formularin pranë KQZ-së më datë 17.11.2020, duke kërkuar rivendosjen në afat, për shkak se shkelja e afatit dhjetë ditor ishte shkaktuar nga faktorë që nuk vareshin prej tij. Ai depozitoi në KQZ vërtetime, sipas të cilave rezultonte se ai kishte postuar formularin e vetëdeklarimit nëpërmjet Postës Shqiptare që më datë 20.10.2020. Rrethanat e faktit provojnë, se objekti postar i pretenduar i dërguar në këtë datë nuk ka mbërritur kurrë në KQZ. KQZ-ja ka administruar formularin e vetëdeklarimit që shoqëronte ankesën e subjektit dhe, mbi këtë bazë, ka ndërprerë procedurën ligjore të verifikimit për kandidaten znj. Leonora Hyso, pa e përfshirë atë në këtë vendimmarrje (pa i dhënë mundësinë për t'u dëgjuar apo ngritur pretendime), ka riçelur procedurën për kandidatin z. Rudi Pashaj dhe me vendimin e Komisionerit nr. 30, datë 15.12.2020 "Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit z. Rudi Viron Pashaj nga lista

shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vlorë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" ka autorizuar këshillin e bashkisë Vlorë që t'i japë mandatin e këshilltarit z. Rudi Pashaj.

3. Në datën 9 mars 2021 ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në KAS znj. Leonora Hyso. Ankimi është protokolluar me nr. 1791 prot. Objekti i ankimit është:
 - a) Kundërshtimi i vendimit të Komisionerit nr. 30, datë 15.12.2020;
 - b) kthimin në vendin vakant të Partisë Demokratia Sociale të kandidatës për këshilltare në këshillin bashkiak Vlorë, znj. Leonora Kiço Hyso;
 - c) vlerësimin e dëmit moral të shkaktuar nga Komisioneri Shtetëror për përgojimin e figurës së zj. Leonora Kiço Hyso.
4. Ankuesja ka kontestuar rivendosjen në afatin e shqyrtimit të kandidatit z. Rudi Pashaj, për shkak se KQZ-ja nuk ka bërë hetim të thelluar lidhur me pretendimin se formulari i vetëdeklarimit ishte postuar prej tij në Postën Shqiptare brenda afatit, por nuk ishte bërë e mundur mbërritja në kohë e objektit postar në KQZ, për shkak të vështirësive të krijuara nga pandemia. Mandati nr. 9401, datë 20.10.2020 i Postës Shqiptare që vërteton dërgesën përmban të dhëna të padeshifrueshme dhe eventualisht kontradiktore, të cilat duhet të ishin hetuar paraprakisht nga KQZ-ja për të provuar vërtetësinë e tij. Formulari i vetëdeklarimit është plotësuar prej ankueses në mënyrë të rregullt dhe nuk përmban të dhëna që mund t'a pengojnë atë në marrjen e mandatit.
5. Ankimi iu paraqit KAS-it, i cili caktoi relator z. Ilirjan Rusmali dhe vendosi zhvillimin e seancës përgatitore për shqyrtimin e kërkesës ankimore në datën 11.03.2021, ora 12:00, duke thirrur në seancë ankuesen znj. Leonora Hyso dhe personin e interesuar z. Rudi Pashaj. Seanca përgatitore u zhvillua në praninë e ankueses dhe të përfaqësuesve të administratës së KQZ-së. Personi i interesuar, i njoftuar rregullisht nuk u paraqit në seancë. Pasi dëgjoi pretendimet e ankueses dhe sqarimet e administratës së KQZ-së, lidhur me kompetencën, legjitimitimin e palëve, afatet dhe formën e ankimit,

KAS-i konstatoi:

1. Kërkesa ankimore është paraqitur për një çështje që ka lidhje me procedurat e zëvendësimit të përfaqësuesve të zgjedhur lokalë, posaçërisht me verifikimin e zgjedhshmërisë në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i cili është kompetencë ligjore e KQZ-së dhe ushtrohet në emër të saj nga Komisioneri (shkronja "n" e pikës 1 të nenit 19). Në ushtrim të kësaj kompetence,

Komisioneri ka marrë vendimin nr. 30, datë 15.12.2020, i cili është akt administrativ individual, në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative (KPrA).

2. Neni 129 i KPrA parashikon se mbrojtja gjyqësore e të drejtave apo pretendimeve mund të bëhet vetëm pasi të jenë shteruar mjetet ligjore administrative. Kodi Zgjedhor njih ankimimin administrativ si mjet ligjor për mbrojtjen e interesave të ligjshme, sepse i ka njohur KAS-it kompetencën për të shqyrtuar dhe zgjidhur në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit (shkronja "b" e pikës 1 të nenit 21, pika 2 e nenit 124/1 të KZ). Kompetenca sipas shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 21 është thelbësore për strukturën tripalëshe të organeve drejtuese të KQZ-së. Ajo qëndron si garanci ligjore dhe plotëson drejtimin monokratik të institucionit. Kompetenca e KAS-it për të shqyrtuar ankimet ndaj akteve të Komisionerit nuk dublon apo zëvendëson Komisionerin në ushtrimin e kompetencave të veta. Kompetencat ngelen të Komisionerit. Kodi Zgjedhor thjesht ka shtuar një instrument ligjor mbrojtës ndaj arbitraritetit tendencial të organit monokratik, instrumentin e ankimit administrativ. Përpara riorganizimit të KQZ-së, ankimi bëhej drejtpërdrejtë në gjykatë, për shkak të formës së drejtimit të institucionit nga një trupë kolegjiale. Këtë arsyetim dukshëm përfaqëson edhe Komisioneri, i cili së fundmi njih dhe referon tek kompetenca e KAS-it si instancë e ankimit administrativ ndaj akteve të tij të të njëjtës natyrë. Prandaj, KAS-i konfirmon kompetencën e tij ligjore për shqyrtimin e këtij ankimi dhe të çdo ankimi ndaj vendimeve të Komisionerit të dala në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

3. Ankuesja është thirrur në një procedurë administrative nga KQZ-ja me shkresën nr. 1672 prot., datë 06.11.2020 të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit. Thirrja në procedurë administrative krijon disa të drejta procedurale dhe akordon disa garanci ligjore për ankuesen, të cilat nuk mund të neglizhohen. Këtu bën pjesë, bashkë me të drejtën për të depozituar formularin e vetëdeklarimit, p.sh. e drejta për t'u dëgjuar, për të paraqitur pretendime, për të marrë dhe dhënë informacione, për të depozituar dokumentacione etj.

Një e drejtë e rëndësishme e procesit administrativ është e drejta për t'u ankuar ndaj akteve apo veprimeve të organit administrativ. Shkresa e KQZ-së nr. 1672 prot., datë 06.11.2020 drejtuar ankueses ka krijuar një interes të ligjshëm për ankuesen, mbrojtja e të cilit me mjetet e ankimit administrativ është legjitime. Prandaj KAS-i konstaton, se ankuesja legjitimohet në paraqitjen e këtij ankimi.

4. Ankimi është paraqitur në formën e "kundërshtimit" të aktit administrativ, është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga ankuesja, ka identitetin e plotë dhe të dhënat për adresën dhe

komunikimin, ka shpjegime dhe referencat ligjore ku mbështetet ankimi, si dhe ka bashkëlidhur vendimin që kundërshtohet dhe dokumentacionin provues që ankuesja gjykon se i shërben ankimit. Nga zbërthimi i objektit të paraqitur të ankimit kuptohet se “kundërshtimi” nënkupton anullimin e vendimit nr. 30, datë 15.12.2020, për shkak se kërkon që pasojat të shtrihen në të shkuarën (pika 2 e nenit 113 të KPrA) dhe të rikrijohet vakanca. Prandaj, duke pranuar elementët e formës, KAS-i saktëson se objekti i ankimit është anullimi i vendimit të Komisionerit nr. 30, datë 15.12.2020.

5. Neni 124/1 i Kodit Zgjedhor parashikon se ankimi në KAS kundër akteve të Komisionerit në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit, kurse për periudhën tjetër paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendimit. Afati 30 ditor përkon me afatin e përgjithshëm të përcaktuar nga pika 1 e nenit 132 të KPrA. Qëllimi i vendosjes së dy afateve të ndryshme ankimi nga KZ, në varësi nga periudha kur lind e drejta e ankimit, ka lidhje me nevojat e procesit zgjedhor dhe domosdoshmërinë për gjykimin urgjent të mosmarrëveshjeve zgjedhore. Mosmarrëveshjet e një natyre tjetër nga ajo zgjedhore nuk e kanë këtë nevojë dhe urgjencë. Përfshirja e tyre thjesht për ko incidencë kohore në afatin e shkurtër të ankimit redukton hapësirën për subjektet që kanë interes të ligjshëm, për të mbrojtur interesin e tyre, gjë që bie ndesh me parimin e procesit të rregullt ligjor. Për këtë arsye, KAS-i gjykon se, pavarësisht nga ko incidencia kohore, çështjet që nuk lidhen me zgjedhjet në proces administrimi dhe që trajtohen e zgjidhen nga Komisioneri paralelisht me çështjet zgjedhore duhet t’i nënshtrohen, ndryshe nga çështjet zgjedhore, afatit 30 ditor të ankimit.
6. Vendimi i Komisionerit nr. 30, datë 15.12.2020, sipas informacionit të dhënë nga administrata e KQZ-së është publikuar më datë 16.12.2020. Nga kjo datë ai është bërë i aksesueshëm për publikun dhe ankuesja ka pasur mundësi të njihet me përmbajtjen e tij.
Afati i ankimit ndaj vendimit nr. 30, datë 15.12.2020 për të gjitha palët e treta, që kanë një interes të ligjshëm lidhur me të ka filluar të konsumohet, duke filluar nga data 17.12.2020. Ankuesja ka marrë dijeni për ndërprerjen e procedurës së verifikimit në favor të saj me shkresën e KQZ nr. 2710, datë 31.12 2020, nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit. Afati i ankimit ndaj ndërprerjes së procedurës së verifikimit ka filluar të konsumohet, duke filluar nga data 03.01.2021 (në përputhje me pikën 2 të nenit 155 të KPrA). Në këtë periudhë, ankuesja nuk është investuar në procedura ankimore, por ka nisur korrespondencë me KQZ-në në bazë të së drejtës për informim, për të grumbulluar dokumentacionin që kishte lidhje me praktikën administrative të z. Rudi Pashaj. Fati i kësaj korrespondence bëhet irrelevant, sa kohë që ankuesja nuk ka nisur asnjë procedurë ankimimi

si ndaj vendimit të Komisionerit nr. 30, datë 15.12.2020, ashtu dhe ndaj vendimit të tij për të ndërprerë verifikimin e vetëdeklarimit për ankuesen. Afati 30 ditor i ankimit, për vendimin nr. 30, datë 15.12.2020 ka përfunduar më datë 15.01.2021, kurse për vendimin për ndërprerjen e procedurave të verifikimit për ankuesen ka përfunduar më datë 01.02.2021.

7. Vendimi i Komisionerit nr. 30, datë 15.12.2020 është një akt administrativ që i ka ezauruar pasojat e veta juridike. Ai ka pasur objekt autorizimin e vazhdimit të procedurave për dhënien e mandatit për z. Rudi Pashaj. Sipas nenit 104 të KPrA akti administrativ ezauron pasojat juridike kur mbaron afatit ose kur plotësohet qëllimi i tij. Anullimi apo shfuqizimi i aktit administrativ kanë ligjërisht kuptim sa kohë që akti nuk i ka ezauruar pasojat juridike. Në rastin objekt shqyrtimi, vendimi i Komisionerit nr. 30, datë 15.12.2020 ka realizuar qëllimin në momentin që këshilli bashkiak është mbledhur dhe ka vendosur dhënien e mandatit të këshilltarit z. Rudi Pashaj, sepse kompetenca për dhënien dhe heqjen e mandatit të këshilltarit bashkiak i takon këshillit bashkiak (pika 2 e nenit 49 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”: Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit). Pas dhënies së mandatit, shkaqet, mjetet ligjore dhe afatet e ankimit përcaktohen nga ligje të tjera dhe kompetenca për shqyrtimin e tyre nuk i përket më KQZ-së. Në këtë kuptim, ankuesja ka humbur edhe këtë afat specifik që kushtëzon ankimin, afatin kur akti administrativ humbet fuqinë, për shkak se ka realizuar qëllimin për të cilin ka dalë.
8. Pavarësisht faktit se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka kompetencën për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit në zbatim të nenit 10 pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” të ndryshuar, mandati i z. Rudi Pashaj nuk kundërshtohet në bazë të nenit 2 të këtij ligji që përcakton rastet e ndalimit për kandidim dhe për t’u zgjedhur në një funksion të lartë publik, por kundërshtohet për shkaqe procedurale të parashikuara në Kreun II të vendimit të Kuvendit Nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Nëse ankimi administrativ në KAS do të ishte ushtruar brenda afatit 30 ditor siç është shtjelluar më sipër, atëherë në zbatim të nenit 133 të K.Pr.Administrative, ekzekutimi i vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve objekt i kësaj procedure ankimi do të ishte pezulluar deri në vendimmarrjen e KAS. Në çdo rast tjetër, nëse KAS do të vlerësonte në themel këtë ankim tej afatit 30 ditor, do të ishte në kushtet e cënimit të parimit të sigurisë juridike në lidhje me mandatin e fituar tashmë nga z. Rudi Pashaj.

9. Në bazë të pikës 2 të nenit 136 të KPrA, KAS-i është i detyruar që të shqyrtojë në seancë përgatitore “nëse ankimi është i pranueshëm dhe vetëm nëse ankimi është i pranueshëm, shqyrton ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar”. Në këtë fazë, KAS-i e ka të pamundur të shqyrtojë meritën, pretendimet për cënim të procesit të rregullt ligjor, paanësinë në shqyrtimin e kërkesave, vërtetësinë e provave dhe saktësinë e gjetjeve. KAS-i, nuk mund të formojë qëndrim dhe as të mbështesë pretendime që kanë lidhje me diskutimin në themel. Mbyllja e hetimit në seancë përgatitore dhe vendimi i KAS-it për mospranimin për shqyrtim të ankimit lidhet vetëm me gjetje që kanë të bëjnë kompetencën, legjitimitimin e palës, afatet dhe formën e ankimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 136, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, njëzëri, KAS-i,

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore të znj. Leonora Hyso me objekt: anulimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.30, datë 15.12.2020, për shkak se është paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 (ditëve), nga shpallja e tij.

Ilirjan RUSMALI - Kryesues

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar



MENDIMIN E PARALEL

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) është krijuar si një nga organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 101 datë 23.07.2020 në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë . Sipas këtij kodi (neni 12/5), KAS është kompetent *për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe për vendosjen e sanksioneve për shkelje të ligjit zgjedhor.*

Ky organ funksionon me kohë të pjesshme dhe sipas nenit 21 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar ka këto kompetenca:

- *vendos shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve ose përsëritjen e tyre;*
- *shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;*
- *shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat e subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ-ve;*
- *vlerëson performancën e komisionerëve dhe numëruesve;*
- *vendos masa disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë kur konstatohen shkelje ose parregullsi në administrimin e materialit zgjedhor;*
- *vendos sanksione administrative kundër personave që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.*

Pra, KAS-i ka kompetencë lëndore të veçantë, çështjet që lidhen në mënyrë ekskluzive me zbatimin e ligjit zgjedhor dhe jo ato që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjeve të tjera të veçanta, siç është në rastin në fjalë, vendimarrja e Komisionerit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’.

Referuar vendimit me Nr. 00-2018-1028 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë:

‘vërehet se mosmarrëveshja konkrete nuk buron nga procesi zgjedhor por nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. (...) Edhe pse, mbështetur në përmbajtjen e këtij ligji (neni 10), kompetencat vendimmarrëse në lidhje me mandatin e deputetëve të Kuvendit që preken nga zbatimi i tij, i janë dhënë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ky i fundit, në këtë rast, nuk vepron si organ i administrimit të procesit zgjedhor.’

Sipas arsytimit të mësipërm të shkëputur nga vendimi i Gjykatës së Lartë, në vendimarrjen e tij për verifikimin e formularëve të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit dhe verifikimin e të dhënave për plotësimin e vakancës në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Vlorë, Komisioneri është vënë në lëvizje dhe ushtruar kompetencat në zbatim të ligjit nr. 138/2015 ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’, dhe për pasojë vendimet e tij lidhur me këtë proces nuk mund të ankimohen në KAS, por në Gjykatën Administrative, që është kompetente për shqyrtimin

e të gjitha mosmarrëveshjeve administrative, me përjashtim të atyre që me ligj janë në kompetencë të organeve të veçanta siç është KAS apo Kolegji Zgjedhor.

Vlen të theksohet se Kodi Zgjedhor në nenin 19, shkronja “n”, parashikon shprehimisht si kompetencë të Komisionerit :

ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Në vështrim të përcaktimeve të sipërcituara, qartësisht Komisioneri ushtron kompetencat që lidhen me zbatimin e ligjet e veçanta, siç janë ato që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit nr. 138/2015 ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’, apo me ligje të tjera të veçanta si p.sh legjislacioni që lidhet me Prokurimin Publik, Shërbimin Civil, etj. Aktet administrative që Komisioneri nxjerr në zbatim të këtyre ligjeve ankohen rast pas rasti në Gjykatën Administrative apo organet të tjera sipas përcaktimeve ligjore.

Përsa më sipër, konkludojmë se KAS duhej të vendoste mospranimin e kërkesës ankimore të znj. Leonora Hyso, jo sipas shkronjës ‘c’ të nenit 130 të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, për shkak të mosrespektimit të afateve ligjore për ankimin; por sipas shkronjës ‘a’ të po të njëjtit nen, për shkak se nuk është organi kompetent për shqyrtimin e ankimit.

Elvin LAKO **Anëtar**

Koli BELE **Anëtar**